	<b>PËRSHKRIM I DETYRAVE TË PUNËS</b>		<b>F-113</b>
	Prishtinë	v. 1.0	Faqe 1 nga 2

## Përshkrimi i detyrave të punës

Pozita	Tre hulumtues për zhvillimin dhe realizimin e hulumtimit për politizimin e institucioneve publike të arsimit të lartë në Kosovë
Kodi i procedurës së rekrutimit	KITU02
Emërtimi i projektit ose programit	KITU02 - Hulumtimi “Politizimi i institucioneve publike të arsimit të lartë në Kosovë”
Kodi dhe emërtimi i aktivitetit	/
#ditëve të punës	45 ditë pune (15 ditë për hulumtues)
Periodha e angazhimit	17 korrik – 15 shtator 2018

### **Qëllimi i konsulencës**

Qëllimi i angazhimit të tre hulumtuesëve është zhvillimi dhe realizimi i hulumtimit për politizimin e institucioneve publike të arsimit të lartë në Kosovë.

### **Përshkrimi i projektit/programit**

Qëllimi i hulumtimit është që të mësohet më shumë për ndikimin e partive politike në institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë, përkatësisht, ndikimin e tyre në zgjedhjen dhe punën e organeve udhëheqëse, stafit akademik dhe të studentëve, si dhe në hulumtimin e interesave dhe përfitimeve të partive politike nga institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë.

Hulumtimi do t’i shfrytëzojë të dhënat në dispozicion nga sondazhet e ndryshme të realizuara nga organizatat e ndryshme të shoqërisë civile për arsimin e lartë në Kosovë, duke synuar të përgjigjet në pyetjet hulumtuese, dhe krahas saj të analizoj të gjitha strukturat udhëheqëse, stafin akademik dhe organizatat studentore në universitetet publike në Kosovë me qëllim të identifikimit të lidhjeve të tyre me partitë politike.

Po ashtu, do të realizohen intervista individuale dhe në fokus grupe me persona që mund të ofrojnë informata rreth pyetjes së hulumtimit, në radhë të parë me studentët. Planifikohet të organizohen 4-5 grupe fokusi me studentë, intervista individuale me profesorë, ekspertë të arsimit, politikëbërës dhe përfaqësues të organizatave studentore.

### **Përshkrimi i hollësishëm i detyrave të punës**


Qëllimi i këtij hulumtimi është që të mësohet më shumë për ndikimin e partive politike në institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë.

Pyetja hulumtuese është:

Cili është ndikimi i partive politike në institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë?

Disa nga nën pyetjet që mund të nxirren prej këtu janë:

1. Cili është ndikimi i partive politike në zgjedhjen dhe punën e organeve udhëheqëse

	<b>PËRSHKRIM I DETYRAVE TË PUNËS</b>		<b>F-113</b>
	Prishtinë	v. 1.0	Faqe 2 nga 2

të institucioneve publike të arsimit të lartë në Kosovë?

2. Cili është ndikimi i partive politike në zgjedhjen dhe punën e stafit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë në Kosovë?
3. Cili është ndikimi i partive politike të studentët e institucioneve publike të arsimit të lartë në Kosovë?
4. Cilat janë interesat dhe përfitimet e partive politike nga institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë?

#### **Rezultatet e pritshme**

- Hartohet plani për hulumtimin cilësor
- Zhvillohen instrumentet për hulumtim
- Realizohen intervistat individuale dhe fokus grupet dhe bëhet transkriptimi i tyre
- Përgatitet raporti i hulumtimit
- Prezantohet raporti i hulumtimit

#### **Kualifikimet**

- Kualifikim i nivelit baçelor, preferohet niveli master.
- Njohje e mirë e sistemit të arsimit të lartë në Kosovë.
- Njohuri të mira të metodave themelore të hulumtimit në shkencat shoqërore.
- Njohje solide e softuerëve statistikorë.
- Njohje e shkëlqyeshme e gjuhës shqipe dhe angleze.

#### **Raportimi**

Hulumtuesit i raportojnë menaxherit të projektit, Kushtrim Bajrami.